

UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A

Udhëzim për vendosjen e matësave inteligjentë (smart), për kontratat e reja të furnizimit me ujë të pijshëm, që do të lidhen nga subjektet ndërtuese.

1. Qëllimi dhe baza ligjore

1.1 Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurën për vendosjen e matësave inteligjentë (smart) (mekanik me modul transmetimi, ultra sonik, elektro-magnetik), për kontratat e reja të furnizimit me ujë të pijshëm që do të lidhen nga subjektet ndërtuese.

1.2 Udhëzimi mbështetet në VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjellës-Kanalizimeve” sh.a., në Kontratën e Shërbimit Ujësjellës – Kanalizime e miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) nr. 8, datë 08.07.2011 “Për miratimin e Modelit të Kontratës Tip”, ndryshuar me vendimin e KKRRU- së nr. 25, datë 08.07.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kontratën model të shërbimeve ujësjellës – kanalizime, në ligjin nr. 126/2020, datë 15.10.2020 “Për metrologjinë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Fusha e Zbatimit

2.1 Fusha e zbatimit të këtij Udhëzimi, është për të gjitha kontratat e reja që do të lidhen, për të gjitha kategoritë e konsumatorëve, sipas kërkesave të subjekteve ndërtuese, për lidhje kontratash të reja në objektin e ndërtuar prej tyre.

3. Standartet teknike të ujëmatësave

3.1 Ujëmatesit inteligjentë (smart) (mekanik me modul transmetimi, ultra sonik, elektro-magnetik) duhet të jenë të çertifikuar dhe në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të vlefshme për pajisjet matëse të ujit të pijshëm.

3.2 Shoqëria “UKT” sh.a., nuk do të pranojë nga subjektet ndërtuese, projekte teknike që parashikojnë pajisje ujëmatëse me mekanizëm konvencional (jo-smart).

3.3 Ujëmatësat që nuk përmbushin kriteret ligjore dhe që nuk janë inteligjent (smart) mekanik me modul transmetimi, ultra sonik ose elektro-magnetik, nuk do të çertifikohen nga “UKT” sh.a.

4. Procedura e vendosjes së ujëmatësave inteligjent

4.1 Procedura për vendosjen e matësave inteligjent (smart) (mekanik me modul transmetimi, ultra sonik, elektro-magnetik), kryhet pas depozitimit të kërkesës nga ana e subjektit ndërtues për vulosjen e tij.

4.2 Ujëmatësat inteligjent (smart) (mekanik me modul transmetimi, ultra sonik, elektro-magnetik), sigurohen nga subjekti ndërtues me kusht që të përmbushen kriteret teknike dhe të jenë të çertifikuara.

4.3 Në objektin e ndërtuar nga subjekti ndërtues, do të vendosen këta ujëmatës:

- Ujëmatësat individual inteligjent (smart) (mekanik me modul transmetimi, ultra sonik, elektro-magnetik), për çdo njësi banimi apo shërbimi;

- Ujëmatësi i bilancit inteligjent (smart) (mekanik me modul transmetimi, ultra sonik, elektromagnetik).

5. Përgjegjësitë e strukturave të UKT sh.a

5.1 Strukturat përgjegjëse në UKT sh.a, në shqyrtimin e çdo kërkesë për hartimin e projektit të pikës së lidhjes së ujit, do të të përcaktojnë specifikimet që duhet të plotësojë matësi sipas dimensioneve dhe kushteve me të cilat operon “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a.

5.2 Strukturat përgjegjëse të UKT sh.a do të bëjnë vulosjen e matësive sipas standarteve teknike për ujëmatësat individual, inteligjent (smart) (mekanik me modul transmetimi, ultra sonik, elektromagnetik), për të gjitha rastet e lidhjes së kontratave të reja.

SPECIFIKIME TEKNIKE PËR MATËSIT INTELIGJENTË TË UJIT

1) Standardet dhe Përputhshmëria

- **Matësit:** MID 2014/32/EU (MI-001), OIML R49 / ISO 4064.
- **Klasa e saktësisë:** $\geq$ R160-H (ose më e lartë); për DN > DN40 lejohet R80-H.
- **Saktësia e matjes:**
 - Elektromagnetik: 0.5–1% (Klasa 1 ose 2).
 - Ultrasonik: 1–2% (Klasa 1 ose 2 ISO).
- **Mbrojtja:** Trup anti-korroziv, IP68 për pajisjen matëse dhe modulët e komunikimit.
- **Presioni i punës:** PN16 (minimum); rezistencë ndaj çarjes sipas standardeve të prodhuesit.
- **Përputhshmëri BE:** RED 2014/53/EU, EMC 2014/30/EU, RoHS 2011/65/EU.
- **Temperatura e punës:**
 - Ujë i ftohtë T30 (ose T50 sipas zonave).
 - Opsional T90 për ujë të ngrohtë ku kërkohet.
- **Certifikim:** Certifikatë kalibrimi + Deklaratë Përputhshmërie (DoC).

2) Karakteristika Funktionale

- **Regjistrim të dhënash:** Interval logjimi i programueshëm (p.sh. 15/30/60 min, ditor).
- **Ngjarje / Alarme:** rrjedhje e vazhdueshme, prishje, kthim rrjedhe, manipulim magnetik/mekanik, temperaturë ngrirje, presion/impuls (nëse sensori është i disponueshëm).
- **Jetëgjatësi baterie:** $\geq$ 10 vite (me interval raportimi ditor).

- **Programim & OTA:** Përditësim në distancë (OTA) i firmëare-it dhe konfigurimit, me ndarje të sigurt dhe nënshkrim digjital.
- **Valvul mbyllëse (opsionale):** Komandim on/off në distancë, verifikim i pozitës, profile sigurie.
- **Regjistrimi shtesë:** prurja çastit, vëllimi total, presioni dhe temperatura (nëse sensori i disponueshëm).
- **Avantazhet kryesore:** Pa pjesë lëvizëse, mirëmbajtje minimale, shumë i saktë, i qëndrueshëm në kohë, i përshtatshëm për aplikime urbane dhe industriale.

3) Teknologjitë e Komunikimit

- **LoRa / LoRaÄAN (EU868):** Klasa A (min.), Klasa C (opsionale), ADR, gateëays me backhaul Ethernet/4G/5G.
- **wM-Bus / OMS:** 169/433/868 MHz, profile T/C, kompatibilitet OMS.
- **MBUS (kabllor):** EN 13757-2/-3; koncentratorë me RS485/TCP-IP.
- **NB-IoT / LTE-M / 2G fallback:** SIM menaxhueshme, APN privat, TLS 1.2+.
- **Kanale të tjera:** (S)MTP, (S)FTP/FTPS, HTTPS (SMTP vetëm për njoftime/skedarë me enkriptim).
- **Opsione komunikimi hibride:** e preferueshme kombinimi i dy ose më shumë teknologjive për mbulim maksimal.